

Lista e institucioneve publike, 2019

Tiranë, më 16 Shtator 2020: INSTAT, ofron për përdoruesin listën e institucioneve publike që janë pjesë e sektorit të Qeverisë së Përgjithshme si dhe korporatat Financiare dhe Jo-financiare që janë në pronësi të entiteteve publike për vitin 2019.

[Lista e institucioneve publike, pjesë e sektorit publik \(link\)](#)

Njësitë shpenzuese buxhetore të Sektorit publik përbëhen nga: nën-sektori i Qeverisë Qëndrore (S.1311) me 900 njësi shpenzuese buxhetore, nën-sektori i Qeverisë Lokale (S.1313) me 195 njësi shpenzuese buxhetore dhe nën-sektori Fondet e Sigurimeve (S.1314) me 2 njësi shpenzuese.

Ndryshimi i numrit të njësive shpenzuese buxhetore vjen si rrjedhojë e ndryshimeve strukturore të Qeverisjes Qëndrore, riklasifikimeve, si dhe njësive të reja apo të mbyllura.

Tab. 1 Sektori Publik në Shqipëri, Viti 2019

	Nën-sektorët	Viti 2019
Qeveria Qëndrore	S.1311	966
Buxhetore ^[1]		900
Extra-Buxhetore		66
Qeveria Federale ^[2]	S.1312	-
Qeveria Lokale	S.1313	283
Buxhetore		195
Extra-Buxhetore		88
Fondet e Sigurimeve	S.1314	2
Korporatat Publike Jo-financiare	S.11001	16
Korporatat Publike Financiare	S.12701	1
Banka Qëndrore	S.121	1
Totali i Njësive Shpenzuese		1.269

Njësitë extra-buxhetore të Sektorit publik përbëhen nga nën-sektori i Qeverisë Qëndrore (S.1311) me 66 njësi shpenzuese dhe nën-sektori i Qeverisë Lokale (S.1313) me 88 njësi shpenzuese.

Përveç institucioneve buxhetore dhe extra-buxhetore, sektori publik, përfshin edhe nën-sektorin e Korporatave Publike Jo-financiare (S.11) me 16 njësi, nën-sektorin e Korporatave Publike Financiare (S.12) me 1 njësi dhe nën-sektorin e Bankës Qëndrore (S.121) me 1 njësi.

¹ Numri i njësive buxhetore përfshin njësitë shpenzuese të raportuara në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë, në Ministrinë e Financave dhe e Ekonomisë, gjatë vitit 2019.

² S.1312 - Qeveria Federale, ky nën-sektor nuk aplikohet në Shqipëri.